



Eshte rikthyer "derbi" i kryeqytetit ne nje atmosfere fantastike. Interesim i madh per nje ndeshje te kampionatit shqiptar ku dy skuadrat e kryeqytetit dhuruan nje takim me emocione te shoqeruar me intensitet dhe tension.

Skuadra e Partizanit e rikthyer pas 5 vjetesh ne Kategorine Superiore shfrytezoi nje gabim te portierit tiranes per te vendosur rezultatin perfundimtar 1-0, kur Ertan Demiri realizoi me koke pas krosit te ardhur nga nje goditje denimi nga krahu i djathte i sulmit te Partizanit.

Si Tirana dhe Partizani krijuan raste per shenim gjate ketij takimi. Lojtaret e Tiranes ne dy momente deçizive, nje ne pjesen e pare dhe nje ne pjesen e dyte kerkuan me institim qe gjyqtari Jemini tu akordonte ne favor dy penalti te cilat ishin te diskutueshme si raste.

Me kete fitore Partizani ngjitet ne vendin e trete ne klasifikim me nje pik me pak se dy kryesueset Skenderbeu dhe Teuta